



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:912453

Datë: 12.01.2021

Numri i dokumentit: 01455588

Ac.nr.1187/2017

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegji të përbërë nga gjyqtarët Kujtim Pasuli – kryetar i kolegjit, Nenad Llaziq e Makifete Saliuka - anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit F.B. nga Fshati ... Komuna Ferizaj, të cilin me autorizim e përfaqëson av. S.M. nga Vitia, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “I...” sh.a me seli në Prishtinë, për shkak të kompensimit të dëmit, duke vendosur sipas ankesave të paditurës dhe të autorizuarit të paditësit, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, C.nr.833/13 të datës 25.01.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me 12.01.2021, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. Pranohet pjesërisht ankesa e të autorizuarit të paditësit F.B. nga Fshati ...ë Komuna Ferizaj av. S.M. nga Vitia lidhur me dispozitivit nën I, dhe **NDRYSHOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj C.nr.833/13 të datës 25.01.2017, që ka të bëjë me shpërblimin e dëmit jo material për dhimbje fizike dhe frikë, ashtu që gjykohet në emër të dhimbjeve fizike shuma prej 4.000,00 €, dhe në emër të frikës shuma prej 3.000,00 €, ndërsa pjesa tjetër mbi shumat e aprovuara **REFUZOHEN** si të pabazuara.

Në pjesën tjetër ankesa e të autorizuarit të paditësit F.B. nga Fshati ...ë Komuna Ferizaj av S.M. nga Vitia, e paraqitur kundër aktgjykimit në fjalë refuzohet si e pa bazuar.

II. Pranohet pjesërisht ankesa e paditurës KS “ I...” sh.a, me seli në Prishtinë dhe **NDRYSHOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj C.nr. 833/13 të dt. 25.01.2017, që ka të bëjë me shpenzimet e procedurës kontestimore ashtu që gjykohet: Detyrohet e paditura që paditësi t’ia kompensoi shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 1.050,00€, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë si dhe përkitazi për kërkesën aksesore për kamatën dhe gjykohet me kamatë sikurse për mjetet e deponuara mbi një vit pa destinim të caktuar duke e llogaritur atë nga dita e marrjes së aktgjykimit datë 25.01.2017, e deri në pagesën definitive.

Në pjesën tjetër ankesa e paditurës e paraqitur kundër aktgjykimit në fjalë refuzohet si e pa bazuar.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e goditur nën I të dispozitivit është miratuar pjesërisht kërkesëpapia e paditësit F.B.t nga Fshati ..., Komuna Ferizaj, dhe detyrohet e paditura Kompania e sigurimeve "I..." me seli në Prishtinë, që paditësit në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material të pësuar t'ia paguaj shumat si në vijim: për dhimbje fizike shumë prej 3.000 €, për frikë shumë prej 2.000 €, për zvogëlimin e aktivitet jetësor shumë prej 3.000 €, për ushqim të përforcuar shumë prej 500 €, për përkujdesje dhe ndihmë nga personi i tretë shumë prej 250 €, dhe për terapi fizikale shumë prej 728 €, e gjithsej në emër të kompensimit të dëmit jo materiale dhe material shumë prej 9.478,00 €, të cilën shumë e paditura është e detyruar t'ia paguaj paditësit me kamatë e cila do të llogaritet sipas lartësisë që llogarisin bankat për deponime të rëndomta të qytetarëve, të afatizuara për periudhën 1 vjeçare pa destinim të caktuar, duke filluar nga data e parashtrimit të padisë 26.11.2013, e deri në muajin dhjetor të viti 2012, ndërsa prej janarit prej viti 2012 e deri në pagesën e tërësishme me kamatë prej 8% si dhe shpenzimet e kësaj procedure në shumë prej 2.587,60 €, ndërsa taksën për përpilimin aktgjykimit në shumë prej 50 € në llogarinë e kësaj gjykate të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë. Nën II të dispozitivit është refuzuar si e pabazuar kërkesëpapia e paditësit F.B. nga Fshati ..., Komuna e Ferizaj e ushtruar kundër të paditurës kompania e sigurimeve "I..." me seli në Prishtinë, për dhimbje fizike shumë prej 9,500 €, për frikën e përjetuar shumë prej 6.000 €, në emër të rentës shumë prej 5.300 €, për zvogëlimin e aktivitet jetësor shumë prej 1.500 € si dhe shpenzimet e avokatit në shumë prej 606 €.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor kanë ushtruar ankesë e paditura KS "I...", me seli në Prishtinë dhe i autorizuari i paditësit av. S.M., nga Vitia.

E paditura KS "I...", për shkak të :

- Shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, dhe
- Zbatim të gabuar të drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, në Prishtinë, ta aprovoj ankesën si të bazuar, ashtu që aktgjykimin e goditur të ndryshohet në pikën I lidhur me lartësinë e kërkesëpadiisë se paditësit për të gjitha format e dëmit jo material dhe të ndryshohet edhe lidhur me kamatën e aprovuar si dhe që ka të bëjë me shpenzimet e procedurës kontestimore dhe të gjykohet në shumë prej 1.050 € ose ta prish dhe lënda ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

I autorizuari i paditësit av. S.M. nga Vitia, për shkak të:

- Zbatim të gabuar të drejtës materiale dhe
- Shpenzimet e procedurës, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, në Prishtinë, ta aprovoj ankesën si të bazuar, ashtu që aktgjykimin e goditur ta ndryshoj duke aprovuar edhe pjesën refuzuese ose ta prishë dhe lëndën ta kthej në rigjykim në këtë pjesë të goditur. Ka kërkuar edhe shpenzimet për përpilimin e ankesës në shumë prej 300 €, dhe taksën gjyqësore për ankesë në shumë prej 31 €.

Përgjigje në ankesë ka parashtruar i autorizuari i paditësit av. S.M. nga Vitia, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë ta refuzojë ankesën e të paditurës si të pabazuar dhe argumentuar të ndryshojë aktgjykimin C.nr. 833/13 të ndryshojë vetëm në pjesën sa i përket pjesës refuzuese të miratojë edhe pjesën refuzuese duke aprovuar në tërësi pjesën tjetër të aktgjykimit të gjitha me kamatë ligjore prej 8%, sipas LMD-së, nga dita e ngritjes së padisë dhe të detyroj të paditurën për pagesën për përgjigjen në ankesë sipas TOAK-së 200 €, me taksat gjyqësore.

Duke vlerësuar aktgjykimin e goditur në pajtim me nenin 194 të LPK-së, në kuadër të kufijve të pretendimeve ankimore dhe duke pasur kujdes sipas detyrës zyrtare për shkeljet thelbësore të dispozitave të LPK-së të parapara me nenin 182 par. 2 dhe për zbatimin e drejtë të së drejtës materiale, gjeti se:

Ankesat e të paditurës dhe paditësve janë pjesërisht të bazuara.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi ka parashtruar padi për kompensimin e dëmit jo material dhe material, të pësuar në aksidentin e komunikacionit të ndodhur me dt. 17.09.2010. Me parashtrësën e datë 16.10.2016, i autorizuari i paditësit av. S.M. nga Vitia, ka bërë precizimin e kërkesëpadisë duke kërkuar në emër të dhimbjeve fizike shumë prej 12.500 €, për frikë 8.000 €, për zvogëlimin e aktivitetit jetësor 4.500 €, për ndihëm e personit të tretë shumë prej 250 €, për ushqim të përforcuar shumë prej 500 €, për trajtim klimatik shumë prej 728 € dhe në emër të kompensimit të rentës shumë prej 21.783,50 €, me kamatë ligjore 8 % prej ditës së dorëzimit të padisë dt. 26.11.2013 e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 3.384,60 €.

Gjykata e shkallës së parë, pas administrimit dhe vlerësimit të provave ka marr aktgjykimin më afër të përshkruar si më lart, duke gjetur se baza e kërkesëpadisë vërtetohet nga ekspertiza e komunikacionit dhe nga aktgjykimi penal P.nr.732/11 të datës 10.06.2013 . Sa i përket shumave të gjykuara për paditësin, gjykata e shkallës së parë, vendimin e vet ka mbështetur, përkatësisht ka bazuar në konstatimin dhe mendimin e ekspertëve përkatës mjekësor. Sa i përket rentës të njëjtën ka refuzuar për faktin se paditësi nuk i ka ofruar gjykatës prova se i njëjti ka qenë në marrëdhënie pune, përkatësisht ka pasur pengim në rritjen e vlerës së pasurisë së tij dhe se fitimi i humbur është fitimi për të cilën është i sigurt se i dëmtuari sipas rrjedhës së rregullt të gjërave ose sipas rrethanave të veçanta të rastit do të realizojë në qoftë se debitori-e paditura detyrimin e vet do ta përmbush. Vendimin e vet gjykata e shkallës së parë, bazon në dispozitat e neneve 154, 173, 178, 185, 199, 200, 202, 929 dhe 940 të LMD-së, e lidhur me nenin 323 të LPK-së. Sa i përket kamatës vendimin e bazon në nenin 277 dhe 382.2 të LMD-së, ndërsa vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore e bazon në dispozitiv e nenin 452.1 të LPK-së.

Në një gjendje të tillë të çështjes Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë, duke vlerësuar ankesën e të autorizuarit të paditësit, ka gjetur se gjykata e shkallës së parë, shumat e gjykuar për paditësin në emër të shpërblimit të dëmit jo material për dhimbje fizike dhe frikë, ka marrë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe nuk ka marrë parasysh natyrën e shpërblimit të dëmit jo material, e duke marrë parasysh njëherit edhe rendësin e shkallës së të mirës dhe qëllimit që shërben shpërblim, siç është paraparë me nenin 200 të LMD-së. Kjo gjykatë duke pranuar pjesërisht ankesën e të autorizuarit të paditësit e ndryshojë aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, ashtu që në emër të dhimbjes fizike gjykoj shumë prej 4.000,00 € dhe për frikë shumë prej 3.000,00 €. Gjykata e Apelit e Kosovës shumat e lartcekura gjykojë duke pasur parasysh konstatimin dhe mendimin e ekspertëve mjeko ligjor të cilët kanë përfunduar se paditësi ka pasur lëndimin e rëndë trupor me pasoja të përhershme e që konsistojnë në sindroma e tronditjes trunore, dobësim të gjymtyrëve të sipërme, rrëshqitje e diskut në nivelin C5/C6, sindroma e kompresionit të palcës kurrizore të qafës, ndrydhje e rëndë e muskulaturës së qafës, kokë dhimbje pas traumës së kokës, marramendje pas traumës së kokës, ndrydhje e boshtit kurrizor të regjionit të qafës e që manifestohet edhe me mpirje të duarve, duke gjetur se shumat e gjykuara nga ana e gjykatës së shkallës së parë nuk ishin në proporcion me shkallën e dhimbjeve fizike dhe frikës, prandaj në këtë drejtim e ndryshojë shumat e gjykuara si në

dispozitiv. Kjo gjykatë tani konsideron se me ndihmën e këtyre shumave të gjykuara për paditësin, ai mund të përjetoj një satisfaksion të konsiderueshëm dhe njëherit duke konsideruar se tani këto shuma të gjykuara janë reale dhe komfor kritereve dhe praktikave të gjykatave në Kosovë.

Në pjesën tjetër ankesa e të autorizuarit të paditësit u refuzua ngase në këto pjesë nuk ka shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë dhe me zbatim të drejtë të së drejtës materiale, drejtë është vendosur.

Duke vlerësuar ankesën e paditurës kjo gjykatë gjeti se ankesa e paditurës KS "I..." sh.a. është pjesërisht e bazuar, vetëm sa i përket shpenzimeve të procedurës kontestimore dhe kamatës. Kjo për faktin se ankesa me të drejtë tregon se në aktgjykim , përkatësisht në arsyetim gjykata e shkallës së parë, tregon se ka aprovuar shpenzimet procedurale për parashtrimin e padisë dhe precizimin e saj në shumë prej 208€ (104x2=208), për dy seanca të shtyra shumë prej 135€ (2x67.5=135), për tri seanca të mbajtura shumë prej 405€ (3x135=405) dhe 302€ për ekspertiza dhe kur këto shuma të aprovuar mbliidhen jep shumë e shpenzimeve në vlerë të përgjithshme prej 1.050€, e jo siç është aprovuar në dispozitiv në shumë prej 2.587,60€, prandaj nga arsyet e theksuara edhe u pranua ankesa dhe u ndryshuar si më lartë.

Gjykata e Apelit e Kosovës vlerësojë se lidhur me caktimin e kamatës aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është marr me zbatim të gabuar të së drejtës materiale, përkatësisht me zbatim të gabuar të dispozitave të neneve 277 dhe 382.1 të LMD-së, sepse kamata e përcaktuar nuk duhet të llogaritet nga dita e parashtrimit të padisë, por ajo llogaritet nga data e marrjes së aktgjykimit, andaj edhe për këtë fakt në këtë pjesë aktgjykimi i goditur me ankesë u ndryshua si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Në pjesën tjetër ankesa e paditurës u refuzua, ngase në këto pjesë nuk ka shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë dhe me zbatim të drejtë të së drejtës materiale, drejtë është vendosur.

Nga arsyet e cekura kjo gjykatë vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e në pajtim me nenin 195. par. 1 pika d) dhe e) të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.1187/17 me dt. 12.01.2021

Kryetari i kolegjit – gjyqtari
Kujtim Pasuli